



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

AN.nr.1/2022

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Ragip Namani kryetar, Nebojša Boričić dhe Beshir Islami, anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi procesmbajtës, në çështjen juridike administrative të paditësit, F. H., Përmbarues Privat nga P., kundër të paditurës Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, me bazë juridike anulimi Vendimit të organit të paditur-Komisionit Disiplinor, DPL nr. 23/21 të dt. 21.09.2021, duke vendosur lidhur konfliktin për kompetencë lëndore, në mes të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative dhe Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së parë- Departamenti për Çështje Administrative, në Prishtinë të paraqitur nga Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së parë-Departamenti për Çështje Administrative, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 14.11.2022, merr këtë:

### A K T V E N D I M

Për të vendosur lidhur me padinë e paditësit, F. H. Përmbarues Privat nga P., kundër të paditurës Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, kompetente në pikëpamje lëndore caktohet, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

### A r s y e t i m i

Paditësi F. H. ka parashtruar padi në Gjykatë Themelore në Prishtinë-Departament për Çështje Administrative, kundër të paditurës Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës, me kërkesë padi të anulohet si jo i drejtë dhe ligjor Vendimi i organit të paditur, i Komisionit Disiplinor, DPL nr. 23/21 të dt. 21.09.2021, (nr. prot. 01-1480/3 të dt. 27.09.2021), me të cilin është shpallur përgjegjës për shkelje disiplinore, dhe i është shqiptuar masë disiplinore si përmbarues privat, ndalimi ushtrimit të profesionit për periudhë kohore prej 3 (tre), muaj si në diapozitivin e vendimit në shkresa të kësaj lënde. I Njëjti po ashtu ka ushtruar kërkesë-propozim për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, deri sa të vendoset në mënyrë meritore çështja sipas padisë. Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin, A nr. 2318/2021 të dt. 11.10.2021, e refuzon kërkesën e paditësit për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të lartë cekur te paditurit, ndërsa Gjykata e Apelit në procedurë ankimore me Aktvendimin AA nr. 932/2021,e refuzon ankesën e paditësit-propozuesit, ndërsa aktvendimin e shkallës së parë e vërteton.

Me aktvendimin, A nr. 2318/2021 të dt. 05.09.2022, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative shpallet jo kompetent në pikëpamje lëndore për të gjykuar në këtë çështje juridike, sipas padisë së paditësit F. H. kundër të paditurit, dhe pas

plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi lëndën ia dërgon në kompetencë lëndore Gjykatës Komerciale-Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Komerciale, Dhoma e shkallës së parë-Departamenti për Çështje Administrative, pas pranimit të lëndës, nuk e pranon kompetencën lëndore për të vendosur në këtë çështje dhe me aktvendimin KA nr. 1370/22 të dt. 11.10.2022, hap konflikt kompetence në Gjykatë Supreme për të vendosur lidhur me kompetencën, në mes të këtyre dy gjykatave.

Gjykata Supreme duke vendosur lidhur me konfliktin e kompetencës si në kuptim të nenit 13, parag.7 të Ligjit për Gjykatën Komerciale nr. 08/L-015, gjen se për të vendosur këtë lëndë kompetente është Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Me nenin 13 parag.1.12, të Ligjit për Gjykatën Komerciale nr. 08/L-015 përcaktohet se Gjykata Komerciale është kompetente të gjykoj dhe ka juridiksion ekskluziv të gjykoj në shkallën e parë dhe të dytë. 1.12, kontestet administrative të incizuara nga shoqëritë tregtare, kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative.

Në rastin konkret bëhet fjalë për padi të paditësit F.H. si person fizik kundër të paditurës Ministria e Drejtësisë me kërkesë padi për anulimin e Vendimit Vendimi i organit të paditur-i Komisionit Disiplinor, DPL nr. 23/21 të dt. 21.09.2021, dhe nr. prot. 01-1480/3 të dt. 27.09.2021.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme duke patur parasysh nenin 1, të parag. 1.12, të Ligjit për Gjykatën Komerciale sipas të cilit përcaktohet, se gjykata komerciale është kompetent të gjykoj dhe ka kompetencë ekskluzive të gjykoj në shkallë të parë dhe të dytë konfliktet administrative të cilët i iniciojnë shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative, në rastin konkret nuk bëhet fjalë për kontest administrativ të cilin e ka ngritur shoqëria tregtare kundër vendimit përfundimtar administrativ, por kemi të bëjmë me konflikt administrativ të ngritur nga personi fizik, Përmbartuesi Privat, F.H., kundër të paditurës Ministria e Drejtësisë, me kërkesë padi që vendimi përfundimtar i këtij organi, të anulohet si jo i drejtë dhe ligjor dhe të lirohet nga përgjegjësia që i ngarkohet.

Duke patur parasysh theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 13 parag.7 të Ligjit për Gjykatën Komerciale nr. 08/L-015, Gjykata Supreme vlerëson se me që objekt i kontestit është padia e paraqitur nga personi fizik, në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ, nuk janë të qëndrueshme theksimet si në vendimin e shkallës së parë se, padia është iniciuar nga shoqëria tregtare. Prandaj për shqyrtimin dhe vlerësimin e ligjshmërisë së aktit administrativ të organit të paditur të ngritur me padi në këtë lëndë, kompetente në pikëpamje lëndore caktohet Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

## GJYKATA SUPREME- PRISHTINË

AN.nr.1/2022, datë 14.11.2022

Procesmbajtës,  
Sherif Krasniqi

Kryetari i Kolegjit,  
Ragip Namani